



ZRRUK/UTSH-06/07/2014

31 Dhjetor 2013

Në pajtim me autoritetin e dhënë me *Ligjin Nr. 03/L-086, Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit*, të datës 15 Qershor 2008 me të cilën është amendamentuar Rregullorja 2004/49 ("Ligji").

Konform Nenit 15. të Rregullës për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë të datës 24 Dhjetor 2012 (Rregulla ZRRUK R-02/U&K),

Duke u bazuar në të dhënat e aplikacionit për Tarifa Shërbimi të dorëzuara nga KUR "Bifurkacioni" Sh. A., dhe në procesin e zhvilluar të analizave dhe të vlerësimit të tyre,

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim ("ZRRUK") lëshon këtë:

URDHËRESË PËR TARIFA SHËRBIMI

PËR PËRCAKTIM TË TARIFAVE PËR SHËRBIMET E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT QË DUHET TË APLIKOHEN NGA KUR "BIFURKACIONI" Sh. A. FERIZAJ PËR VITIN 2014 NGA PERIUDHA TARIFORE 2012-2014

1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit (UTSH), përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që u atribuohen Rregullës ZRRUK R-02/U&K.

2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifave të Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për KUR "BIFURKACIONI" Sh. A., me rastin e faturimit të Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit që u ofron konsumatorëve të vet në tërë Zonën e saj të shërbimit.

ZRRUK mund t'i bëjë korrigjimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të tarifave të shërbimit në bazë të kërkesës së KUR "Bifurkacioni" Sh. A. në pajtim me nenin 16. të Rregullës ZRRUK R-02/U&K.

3. Përmbajtja e shtojcave të kësaj UTSh-ëje

Shtojcat e kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit përmbajnë;

- 3.1 *Shtojca Nr. 1: Lista e Tarifave të Shërbimit, me sqarimet përkatëse, dhe*
- 3.2 *Shtojca Nr.2: Caqet operative, financiare dhe ato të investimeve kapitale të përcaktuara për t'u arrit nga kompania gjatë vitit 2014.*

4. Afati

Tarifat e përcaktuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit do të jenë të zbatueshme për periudhën **1 janar 2014 deri më 31 dhjetor 2014**, nga procesi rregullator i tarifave për periudhën 2012-2014.

5. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit

- 5.1 KUR "BIFURKACIONI" Sh. A. duhet të shpërndajë Listën e Tarifave të Shërbimit të aprovuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit, tek secili Konsumator në momentin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose së paku një herë në fillim të aplikimit të saj t'i bashkëngjis të njëjtën faturës me të cilën faturohen konsumatorët.
- 5.2 Lista e Tarifave për Shërbime e aprovuar nga ZRRUK me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit duhet të publikohet nga KUR "BIFURKACIONI" Sh. A., së paku në njërën prej gazetave ditore me tirazh gjithë përfshirës në tërë Kosovën, brenda shtatë (7) Ditëve të Punës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ZRRUK në portalin e vet www.wwro-ks.org.

6. Apelet

KUR "BIFURKACIONI" Sh. A. ka të drejtë të apelojë këtë urdhëresë ose pjesë të saja brenda 15 ditëve të punës nga data e publikimit, tek Komisioni Shqyrtues i themeluar konform nenit 34. Komisioni Shqyrtues, pika 34.1., Ligji Nr. 03/L-086 mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës dhe Kanalizimit, të datës 15 Qershor 2008

7. Gjuhët Zyrtare të Urdhëresës për Tarifa Shërbimi

Kjo Urdhëresë për Tarifa të Shërbimit publikohet në tri (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare që përdoren në Kosovë; Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe dhe në Gjuhën Angleze.

Në rast mospërputhje në mes të versioneve UTSH-ës, do të mbizotërojë versioni i shkruar në gjuhën Shqipe.

.....
Raif Preteni
Drejtor i ZRRUK

SHTOJCA 1: LISTA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT

1. Tarifat Fikse dhe Tarifat Volumetrike për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit

Afati i Aplikueshmërisë: 1 janar 2012 – 31 dhjetor 2014

Kategoria e Konsumatorëve	Tarifa Fikse (EURO/muaj)	Tarifa Volumetrike për Shërbime të Ujësjellësit (EURO/m ³)	Tarifa Volumetrike për Shërbime të Kanalizimit (EURO/m ³)
1.1. TARIFAT PA INFLACION TË PËRCAKTUARA PËR VITIN 2012 (1 JANAR 2012 – 31 DHJETOR 2012)			
Shtëpiak	1.0	0.2945	0.1194
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.6478	0.2986
1.2. TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN 2012 MBI BAZËN E INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT TË PUBLIKUARA NGA ASK PËR PERIUDHËN 10/2010-10/2011 (1 JANAR 2012 – 31 DHJETOR 2012)			
Shtëpiak	1.0	0.31	0.13
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.68	0.30
2.1. TARIFAT PA INFLACION TË PËRCAKTUARA PËR VITIN 2013 (1 JANAR 2013 – 31 DHJETOR 2013)			
Shtëpiak	1.0	0.3107	0.1301
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.6214	0.3252
2.2. TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN 2013 JANË PËRSHTAT ME TAKSËN SHITESË ZRRUK TË VITIT 2013, % E RAPORTIT TË SHKALLËS SË REALIZIMIT TË INVESTIMEVE KAPITALE TË VITIT 2012 NË IÇK, PUBLIKUAR NGA ASK PËR PERIUDHËN 10/2010-12/2012 (APLIKUESHMËRIA: 1 JANAR 2013 – 31 DHJETOR 2013)			
Shtëpiak	1.0	0.32	0.13
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.64	0.33
3.1. TARIFAT PA INFLACION TË PËRCAKTUARA PËR VITIN 2014 (1 JANAR 2014 – 31 DHJETOR 2014)			
Shtëpiak	1.0	0.3279	0.1417
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.5902	0.3542
3.2. TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN 2014 (1 JANAR 2014 – 31 DHJETOR 2014)			
Shtëpiak	1.0	0.32	0.13
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.64	0.33

Sqarim:

- Tarifat e aplikuara gjatë vitit 2013 pika 2.2, tani më janë historike.
- Tarifat e aplikueshme për vitin 2014, pika 3.2, janë të njëjta me tarifat e aplikuara gjatë vitit 2013 për periudhën tarifore një vjeçare. Arsyet e mos përshtatjes së tarifave të vitit 2014 me indeksin e Çmimeve të Konsumit në Kosovë (IÇKK) të Agjencionit të Statistikave të Kosovës (ASK) qëndrojnë në faktin se kompania e juaj nuk ka përmbush asnjë cak të përcaktuar me procesin rregullator të tarifave të vitit 2012-2014, për vitin 2013.
- Tarifat fikse edhe ashtu nuk i nënshtrohet rregullimit për inflacion gjatë vitit 2014.

ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës; IÇK – Indeksi i Çmimeve të Konsumit

2. Tarifat për administrim dhe shpenzimet për kyçje në Rrjetin e Shërbimeve të Ujit

Afati i Aplikueshmërisë: 1 janar 2012 – 31 dhjetor 2014

2.1. Tarifa Administrative për Kyçje në Shërbime*	Diametri i gypit të kyçjes/ujëmatësi	Tarifa për kyçje në ujë (€)	Tarifa për kyçje në kanalizim (€)	Shuma (EURO)
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve (*) –Tarifa për administrim është e pakthyeshme dhe nënkuptojmë të drejtën e konsumatorit për tu kyç në rrjetin e shërbimeve të ujit dhe mbajtjen e tij në regjistrin e konsumatorëve aktiv për çështje të ndryshme administrative. Shumat e inkasuara për këtë destinim përdoren për zgjerimin e rrjetës së shërbimeve të ujit.	(13 – 25) mm	30.00	20.00	50.00
	32 mm	90.00	60.00	150.00
	40 mm	150.00	100.00	250.00
	50 mm	240.00	160.00	400.00
	65 mm	300.00	200.00	500.00
	80 mm	420.00	280.00	700.00
	100 mm	570.00	380.00	950.00
	150 mm	840.00	560.00	1,400.00
2.2. Shpenzimet e Kyçjes në Shërbime të Ujësjellësit*	Diametri i gypit të kyçjes/ujëmatësit			Shuma (EURO)
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve (*) - Shpenzimet e Kyçjes në Shërbime përfshijnë shpenzimet e punës dhe materialit në vijim: qafore, pajisjet për kyçje, gypat e kyçjes në gjatësi deri 15 metra, ujëmatësi dhe dy valvula. Punët tokësore dhe ato të betonit nuk janë të përfshira.	(13 – 20) mm			120.00
	(25 – 32) mm			160.00
	(40 – 50) mm			220.00
	> 50mm			Do të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.
2.3. Shpenzimet e Kyçjes në Shërbimet e Kanalizimit *	Diametri i gypit të kyçjes/ujëmatësit			Shuma (EURO)
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve (*) – Shpenzimet e Kyçjes në Shërbime përfshijnë shpenzimin e punës dhe të materialit në vijim: elementet fazonike për kyçje dhe gypit në gjatësi deri 15 metra. Punët tokësore dhe ato të betonit nuk janë të përfshira.	DN 110 mm			100.00
	DN 160 mm			120.00
	DN 200 mm			160.00
	> 200 mm			Do të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.

3. Tarifat për Shërbimet Tjera

Afati i Aplikueshmërisë: 1 Janar 2012 – 31 Dhjetor 2014

Lloji i Shërbimit	Shuma (EURO)
3.1. Dërgimi i njoftimit për shkyçje llogaritet vetëm njëherë brenda një viti kalendarik	3.00
3.2. Shkyçja e Shërbimeve të Ujësjiellit	20.00
3.3. Rikyçja e Shërbimeve të Ujësjiellit	20.00
3.4. Riparimi i rrjedhjeve në objektin e Konsumatorit	Duhet të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.
3.5. Gjoha për kyçje ilegale	100.00
3.6. Gjoha për moskryerje të riparimit të rrjedhjes në objektin e konsumatorit aplikohet pas vërejtjes së parë	100.00
3.7. Shitja e ujit me cisterna të ujit – transporti deri në 5 km	20.00 EURO/5m3
3.8. Riparimi i ujëmatësit nga çmimi i ujëmatësit kur kompania e instalon ujëmatësit e saj	Max. 60% të çmimit të ujëmatësit
3.9. Kontrollimi i ujëmatësit – verifikimi i saktësisë	15.00

Disa nga aspektet e këtyre shërbimeve janë të rregulluara edhe me Rregullën ZRRUK R-03/ U & K.

SHTOJCA 2: CAQET OPERATIVE, FINANCIARE DHE ATO TË INVESTIMEVE KAPITALE TË PËRCKTUARA PËR TU ARRIT NGA KOMPANIA GJATË VITIT 2014

Këto caqe paraqesin obligim kontraktual ndërmjet KRU-së dhe ZRRUK të cilat janë përcaktuar gjatë procesit tarifar 2012-2014, për vitin 2014.

Caqet e aprovuara për përmbushje gjatë vitit 2014	Njësia	Viti 2014	
Të dhënat operative			
1.1 Uji i prodhuar	m³/vit	6,264,269	
1.2 Uji i humbur	m³/vit	2,883,876	
1.3 Uji i faturuar	m³/vit	3,380,393	
1.4 Numri i konsumatorëve	Nr	19,046	
Të dhënat financiare		Me çmimet e vitit bazë 2011	Të përshtatura për vitin 2014 *
2.1 Shpenzimet operative për shërbimet e ujit	€/vit	720,130	782,857
2.2 Shpenzimet operative për shërbimet e kanalizimit	€/vit	53,325	57,970
2.3 Shuma vjetore e shpenzimeve operative	€/vit	773,455	840,826
2.4 Faturimi për shërbimet e ujësjellësit	€/vit	1,573,024	1,710,042
2.5 Faturimi për shërbimet e kanalizimit	€/vit	457,887	497,771
2.6 Shuma e faturimit për dy shërbimet	€/vit	2,030,911	2,207,814
2.7 Arkëtimi për shërbimet e ujësjellësit	€/vit	1,138,263	1,237,411
2.8 Arkëtimi për shërbimet e kanalizimit	€/vit	1,475,614	1,604,147
2.9 Shuma e arkëtimit për dy shërbimet	€/vit	2,613,877	2,841,558
Të dhënat e investimeve kapitale			
3.1 Investimet kapitale për shërbimet e ujit nga burimet vetanake të kompanisë	€/vit	111,643	121,368
3.2 Investimet kapitale për shërbimet e kanalizimit nga burimet vetanake të kompanisë	€/vit	198,883	216,207
3.3 Shuma e investimeve kapitale vetanake	€/vit	310,526	337,574
3.4 Investimet kapitale për shërbimet e ujit nga donatorët	€/vit	300,000	326,132
3.5 Investimet kapitale për shërbimet e kanalizimit nga donatorët	€/vit	-	-
3.6 Shuma e investimeve kapitale nga donatorët	€/vit	300,000	326,132

* Të dhënat financiare të aprovuara për vitin 2014 janë përshtatur me Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK), të publikuara nga ASK, duke marrë për bazë raportin e mesatares së IÇK-ës gjer në fund të Nëntorit 2013 (127.055) me IÇK-në e muajit Qershor të vitit 2011 (121.40), në % 4.658.

ZRRUK edhe gjatë këtij viti do të monitorojë të dhënat e arritura për treguesit kryesor nga kompania për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara të cilat do të publikohen përmes dy raporteve periodike, gjashtë dhe nëntë mujorëve të parë të vitit 2014 dhe atë vjetor pas përmbylljes së vitit biznesor 2014.